Gjatë vitit 2019 numri i vdekjeve të burrave është 11.781, kurse i grave është 10.156 duke shënuar rritje nga viti i kaluar për burrat dhe gratë. Vdekjet sipas grup-moshave tregojnë se burrat kanë një përqindje më të lartë të vdekjeve, duke përjashtuar grup-moshën e fundit mbi 84 vjeç. Kjo ndodh pasi jetëgjatësia e burrave është më e ulët se ajo e grave.

women, 136 children are expected to be born, according to 2019 fertility rates. This index is below the replacement levelof 2.1 children per woman, which means that a couple is unable to replace itself.

Fertility by age group has decreased significantly for age groups of 20-24 and 25-29, while older age groups have experienced a slight increase. In 2019, the mean age at birth was 28.9 years.

Age group specific fertility rate for 2019 demonstrate and indicate that men become parents approximately five years later than women. Meanwhile, men's post-30 fertility rates are higher than women's.

The gross reproduction rate (GRR) is a useful indicator for measuring the growth of future generations. It measures the rate at which women substitute themselves during the reproductive years of their life. The GRR calculation method is equivalent to that of the ISF, but only female births are taken into account. During 2019 GRR is 0.65, which indicates that women in Albania are about 35 % away from their self-replacement. This indicator is directly influenced by women's reproductive behavior, expressed by TFR and the sex ratio at birth. Assuming TFR stable, the collapse of the sexratio at birth would cause the increase of GRR. On the other hand, the increase of TFR presumes the increase of GRR.

Adolescent birth rate has decreased compared to the previous year. In 2019 there are 14.2 births per 1000 girls of the 15-19 age groups, as compared to 14.5 births per 1000 girls of the same age group in 2018.

For each single age of the 15-19 years old age group the percentage of girls who have and haven't given birth is calculated. Percentages are low for the age of 17 as only 1.1 % of girls have given birth. However, this trend increases according to the age, and for the age of 19 stands at 2.9 %.

Deaths

The number of deaths in 2019 for men is 11,781 while for women it is 10,156 thus indicating an increase compared to the previous year for both sexes. Deaths by age groups indicate that in all age groups, men have a higher death rate, with the exception of the over 84 year's old age group. This is caused by the lower life expectancy of men compared to women's.

Vdekshmëria foshnjore është rreth 11,2 vdekje për një mijë lindje për djemtë dhe 9,2 për vajzat. Ky tregues ka pësuar një rritje për djemtë dhe për vajzat, krahasuar me një vit më parë.

Lëvizjet e brendshme

Në vitin 2019, personat që kanë ndryshuar vendbanimin e tyre brenda vendit në total janë 33.780 ku sipas gjinisë 14.059 janë burra dhe 19.721 gra.

Gjatë këtij viti, numri i migrantëve të brendshëm burra ka pësuar një rritje të konsiderueshme, me 55,2 %, ndërsa ai i migranteve të brendshëm gra u rrit me 13,5 %, krahasuar me vitin 2018.

Gjatë gjithë periudhës 2015-2019, numri i migranteve të brendshëm gra ka qenë më i lartë se numri i migrantëve të brendshëm burra, duke shënuar 58,4 % në vitin 2019.

Martesat

Gjatë vitit 2019, në vendin tonë janë regjistruar rreth 22,5 mijë martesa. Tek gratë më shumë se 50 % e martesave realizohen deri në moshën 24 vjeç, dhe deri në moshën 29 vjeç janë kryer 77,7 % e tyre. Kjo shpjegon dhe moshën relativisht të re (krahasuar me burrat) në martesë për gratë e cila është 27,8 vjeç. Për burrat 53,8 % e martesave realizohen deri në moshën 29 vjeç, dhe 81,9 % e martesave deri në moshën 34 vjeç. Mosha mesatare e martesës për burrat është 30,9 vjeç.

Norma e martesave të grave sipas grup-moshave ndër vite tregon se ka një rënie të normës së martesës deri në moshën 24 vjeç. Kjo shpjegon dhe rritjen e moshës mesatare në martesë të vajzave. Krahasuar me 5 vite më parë, gratë martohen relativisht rreth 1.6 vite më të mëdha.

Në këtë publikim janë llogaritur martesat e hershme për vajzat dhe djemtë në mosha teke për grup moshën 15-19 vjeç. Numri i vajzave të martuara para moshës 18 vjeç, gjatë vitit 2019 është 20. Ky numër është ulur në krahasim me një vit më parë, kur u regjistruan 24 martesa të vajzave nën 18 vjeç. Përqindja e vajzave të martuara në moshat 15 deri 17 vjeç është shumë e ulët, ndërsa shënon vlerat më të larta në moshën 18 dhe 19 vjeç, përkatësisht 9,3 % dhe 6,8 %. Ndërsa djemtë nuk kanë martesa para moshës 18 vjeç dhe përqindja e djemve të martuar në moshën 18-19 vjeç është nën 1,0 %.

Infant mortality is about 11.2 deaths per 1,000 births for boys and 9.2 for girls. This indicator has increased for boys and girls compared to the previous year.

Internal movements

During 2019 persons who have changed their place of residence within the country in total are 33,780 where 14,059 are men and 19,721 women.

During this year, the number of internal men migrants has increasedconsiderably by 55.2%, while the number of internal women migrants was increased by about 13.5 %.

Throughout the period 2015–2019 the number of internal migrant women was higher than the number of internal migrant men, marking 58.4% in 2019.

Marriages

During 2019 in our country were registered 22,5 thousand marriages. 50 % of women get married up to the age of 24, and up to 77.7 % of them by the age of 29. This explains the relatively young age (compared to men) for marriage at 27.8 years old for women.

53.8 % of men get married up to the age of 29 and 81.9 % of them get married by the age of 34. The average age for marriage is 30.9 years for men.

The change of marriage rate by age groups over years indicates a decline in the marriage rate up to the age of 24 years old, which explains the slight increase of the average age of women when they get married. Compared to 5 years ago, women marry relatively 1.6 years older.

In this publication, early marriages for both girls and boys have been calculated for single ages of the 15-19 years old age group. The number of married girls before the age of 18 in 2019 was 20. This number has decreased compared to the previous year when there were 24 marriages. Meanwhile, the ratio of married girls at the age of 18 is 9.3 % and 6.8 % for the age of 19. On the other hand, there are no marriages for boys before the age of 18 and the percentage of married boys of 18-19 years of age is under 1,0 %.

Ndryshimet në popullsi

Changes in population

Gjendja në fund të vitit / At the end of the year

Vitet Years	Popullsia-Population		Shtesa natyrore Natural increase		Migracioni neto Net migration		Norma e rritjes vjetore (%) Annual growth rate (%)
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
2015	1.458.451	1.417.141	5.266	5.031	-8.052	-12.549	-0,35
2016	1.453.541	1.423.050	5.118	5.227	-10.060	587	0,03
2017	1.438.609	1.431.715	4.598	4.039	-19.530	4.628	-0,22
2018	1.429.594	1.432.833	3.358	3.772	-12.375	-2.655	-0,28
2019	1.420.613	1.425.342	3.112	3.512	-12.077	-11.005	-0,58

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Dinamikat e popullsisë, burra

Population dynamics, men



Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Dinamikat e popullsisë, gra

Population dynamics, women



Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Piramidat e popullsisë sipas moshës, 1989, 2011, 2019, 2031
Population pyramids, by age 1989, 2011, 2017, 2031



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Raporti gjinor i popullsisë sipas grup-moshës, 2019

Sex ratio by age group, 2019



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Popullsia sipas grup-moshës

Population by age group

Grup-mosha	2011	2019	2031	Age group
Burra				**Men**
Gjithsej	**100%**	**100%**	**100%**	**Total**
0-14	21,5%	17,5%	16,5%	0-14
15-64	67,7%	68,6%	62,1%	15-64
65+	10,8%	13,9%	21,4%	65+
Gra				**Women**
Gjithsej	**100,0%**	**100,0%**	**100,0%**	**Total**
0-14	19,8%	16,6%	15,1%	0-14
15-64	68,3%	68,5%	62,6%	15-64
65+	11,9%	14,9%	22,2%	65+

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT
Shënim: Të dhënat për 2011 i referohen popullsisë sipas Censit 2011, për 2019 i referohen popullsisë mesatare 2019, për 2031 i referohen projeksioneve të popullsisë
Note: Data for 2011 refer Census Population 2011, for 2019 refer average population 2019, for 2031 refer the projection of population

Koeficienti i varësisë së të rinjve

Youth dependency ratio



Koeficienti i varësisë së të moshuarve

Old dependency ratio



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Shënim: Të dhënat për 2011 i referohen popullsisë sipas Censit 2011, për 2019 i referohen popullsisë mesatare 2019, për 2031 i referohen projeksioneve të popullsisë

Note: Data for 2011 refer Census Population 2011, for 2019 refer average population 2019, for 2031 refer the projection of population

Mosha mediane e popullsisë sipas gjinisë

Median age of the population by sex

Vitet / Years	Mosha medianë - Median age		
	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total
2015	33,3	36,2	34,7
2016	33,8	36,7	35,2
2017	34,3	37,0	35,6
2018	35,0	37,2	36,1
2019	36,3	38,2	37,2

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Të lindur gjallë sipas gjinisë

Live births by sex

Vitet Years	Djem Boys	Vajza Girls	Raporti gjinor në lindje Sex ratio at birth
2015	17.103	15.612	110
2016	16.401	15.332	107
2017	16.208	14.661	111
2018	15.025	13.909	108
2019	14.893	13.668	109

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Raporti gjinor sipas rradhës së lindjes, 2019

Sex ratio by birthorder, 2019

Rradha e lindjes Birthorder	Djem Boys	Vajza Girls	Raporti gjinor në lindje Sex ratio at birth
1	6.170	5.618	110
2	5.548	5.176	107
3	2.172	1.976	110
4+	666	555	120
Mungojnë/Missing	337	343	98

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Raporti gjinor në lindje

Sex ratio at birth



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Koeficientët specifikë të fertilitetit sipas grupmoshës dhe indeksi sintetik i fekonditetit

Age group specific fertility rate and total fertility rate

Vitet / Years	Lindje të gjalla / Live births	Lindshmëria sipas grupmoshës për 1,000 gra Age group specific fertility rate per 1.000 women							ISF* / TFR*	KBR** / GRR**	Mosha mesatare në lindje / Mean age at birth
		15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 49			
2015	32.715	20,1	78,7	111,2	77,2	27,8	3,8	0,3	1,60	0,76	27,9
2016	31.733	17,5	74,1	107,1	74,7	29,5	5,0	0,2	1,54	0,74	28,2
2017	30.869	16,2	67,1	100,0	76,9	30,6	5,0	0,3	1,48	0,70	28,4
2018	28.934	14,5	60,6	90,1	73,9	30,1	5,3	0,4	1,37	0,66	28,6
2019	28.561	14,2	57,7	86,2	75,0	33,0	6,0	0,5	1,36	0,65	28,9

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status
Indeksi Sintetik i Fekonditetit - Total Fertility Rate
****Koefiçienti bruto i riprodhimit - Gross Reproduction Rate***

Indeksi sintetik i fertilitetit

Total fertility rate



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Koeficientët specifikë të fertilitetit sipas grupmoshës

Age group specific fertility rate



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Vdekshmëria sipas grupmoshave dhe gjinisë, 2018

Deaths by age group and sex, 2018



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Lindshmëria në adoleshencë sipas moshave teke, 2019

Adolecent birth rate by single age, 2019



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Vdekjet sipas gjinisë

Deaths by sex

Vitet Years	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total
2015	11.837	10.581	22.418
2016	11.283	10.105	21.388
2017	11.610	10.622	22.232
2018	11.667	10.137	21.804
2019	11.781	10.156	21.937

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Vdekjet nën 1 vjeç sipas gjinisë

Infant deaths by sex

Vitet Years	Djem Boys	Vajza Girls	Gjithsej Total
2015	134	99	233
2016	146	131	277
2017	130	118	248
2018	146	111	257
2019	167	126	293

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Status

Vdekshmëria foshnjore për 1000 lindje

Infant deaths per 1000 live births



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Djem - Boys	10,7	10,0	9,2	9,5	9,2	7,8	7,8	8,9	8,0	9,7	11,2
Vajza - Girls	9,9	9,2	8,2	8,0	6,5	8,0	6,3	8,5	8,0	8,0	9,2

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Vdekshmëria sipas grup-moshave dhe gjinisë, 2019

Mortality by age group and sex, 2019



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Jetëgjatësia në lindje

Life expectancy at birth



	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Burra - Men	73,9	74,7	75,3	75,5	75,8	76,2	76,1	77,0	77,1	77,4	77,6
Gra - Women	78,8	79,4	79,8	79,7	80,1	80,1	79,7	80,1	80,0	80,5	80,6

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Lëvizjet e brendshme sipas moshës, burrat

Internal movements by age, men

Grup-mosha Age group	Burra-Men				
	2015	2016	2017	2018	2019
0-4	765	1.370	1.471	471	758
5-9	923	1.545	1.391	757	889
10-14	759	1.253	1.199	551	743
15-19	862	1.275	1.290	469	711
20-24	1.561	1.673	2.065	610	1.204
25-29	2.262	2.784	2.887	1.262	1.970
30-34	1.966	2.448	2.451	1.361	2.037
35-39	1.521	1.604	1.693	845	1.331
40-44	1.152	1.194	1.342	576	945
45-49	955	1.015	1.159	420	781
50-54	775	866	952	328	655
55-59	696	866	986	351	591
60-64	541	782	806	311	462
65-69	507	766	805	355	467
70-74	268	374	405	190	274
75-79	135	209	194	110	144
80-84	76	104	93	58	67
85+	27	33	46	34	30

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Lëvizjet e brendshme sipas moshës, gratë

Internal movements by age, women

Grup-mosha Age group	Gra-Women				
	2015	2016	2017	2018	2019
0-4	748	1.207	1.426	428	718
5-9	797	1.372	1.340	716	870
10-14	752	1.253	1.092	536	719
15-19	2.107	4.453	2.946	860	1.552
20-24	5.563	9.997	6.067	4.223	4.335
25-29	4.262	7.608	5.369	4.341	4.132
30-34	2.115	3.667	2.860	2.291	2.301
35-39	1.080	1.877	1.682	1.135	1.265
40-44	810	1.318	1.239	625	850
45-49	631	1.015	1.072	441	613
50-54	627	966	1.001	387	562
55-59	563	967	924	381	498
60-64	578	1.001	1.050	446	578
65-69	249	407	513	242	356
70-74	186	288	248	120	152
75-79	103	166	186	112	107
80-84	77	115	99	43	54
85+	57	79	67	51	59

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Lëvizjet e brendshme sipas moshës dhe gjinisë, 2015, 2019

Internal movements by age and sex, 2015, 2019





Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Martesat sipas gjinisë dhe grup-moshës

Marriages by sex and age group

Grup-mosha	2015	2016	2017	2018	2019	Age group
Dhëndurët - Bridegroom						
Gjithsej	**24.997**	**22.562**	**22.641**	**23.104**	**22.415**	**Total**
Deri 19	169	88	120	165	153	Up to 19
20 - 24	4.241	2.787	3.225	3.399	3.390	20 - 24
25 - 29	10.466	9.051	9.188	9.057	8.525	25 - 29
30 - 34	6.273	6.600	6.179	6.422	6.284	30 - 34
35 - 39	2.108	2.256	2.155	2.250	2.173	35 - 39
40 - 44	843	915	857	879	896	40 - 44
45 - 49	434	408	432	446	447	45 - 49
Mbi 50	463	457	485	486	547	Over 50

Grup-mosha	2015	2016	2017	2018	2019	Age group
Nuset - Bride						
Gjithsej	**24.997**	**22.562**	**22.641**	**23.104**	**22.415**	**Total**
Deri 19	5.342	3.339	3.827	3.656	3.382	Up to 19
20 - 24	10.407	9.052	8.836	8.734	7.957	20 - 24
25 - 29	5.842	6.342	6.024	6.219	6.070	25 - 29
30 - 34	2.009	2.210	2.182	2.343	2.457	30 - 34
35 - 39	746	819	899	1.029	1.096	35 - 39
40 - 44	345	427	399	530	664	40 - 44
45 - 49	164	194	239	299	362	45 - 49
Mbi 50	142	179	235	294	427	Over 50

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Source: INSTAT, General Directorate of Civil Office

Divorcet me kërkesën e bashkëshortes/bashkëshortit

Divorce at the request of the spouse

Vitet Years	Me kërkesën e bashkëshorit / With request of husband	Me kërkesën e bashkëshortes / With request of wife
2015	2.534	3.000
2016	3.039	3.180
2017	3.042	3.198
2018	3.001	3.578

Burimi: Ministria e Drejtësisë

Source: Ministry of Justice

Përqindja e martesave sipas grup-moshave dhe gjinisë, 2019

Percentage of marriages by age group and sex, 2019



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Përqindja e martesave sipas grup-moshave dhe gjinisë, 2019

Percentage of marriages by age group and sex, 2019



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Martesat e hershme për vajzat, 2019

Early marriages of girls, 2019



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Mosha mesatare e martesës sipas gjinisë dhe diferenca moshore në martesë

Mean age of marriage by sex and the age diference in marriage

Vitet Years	Burra Men	Gra Women	Diferenca e moshës mesatare në martesë Diference of mean age in marriage
2015	30,6	26,3	4,3
2016	31,3	27,0	4,3
2017	31,0	27,0	4,0
2018	31,0	27,4	3,6
2019	30,9	27,8	3,1

Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Mosha mesatare e martesës sipas gjinisë

Mean age of marriage by sex



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Shëndeti

Health

Shëndeti

Health

	I/e dobët Underweight	Normal Normal 18.5-24.9	Mbipeshe Overweight 25.0-29.9	Obez Obese 30
Gra-Women	3,3	41,5	30,8	24,4
Burra-Men	1,8	38,4	41,7	18,1

Përdorimi i alkoolit nga gratë, në (%)

The alcohol consumption from women, in (%)



Shëndeti

Statistikat e shëndetit paraqesin të dhëna të detajuara mbi diferencat gjinore në lidhje me shëndetin dhe faktorët që ndikojnë në shëndet, si shkaqet e vdekjeve, sëmundshmërinë nga HIV/AIDS dhe abortet etj. Klasifikimi i grup sëmundjeve bazohet në klasifikimin ndërkombëtar "ICD-9" të shkaqeve të vdekjes.

Shkaqet e vdekjeve

Shkaqet kryesore të vdekjeve si tek gratë ashtu dhe tek burrat vijojnë të jenë "grup sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut", të cilat shkaktojnë 55,9 % të vdekjeve tek gratë dhe 51,1 % të vdekjeve tek burrat. Dy shkaqet e tjera kryesore janë "simptomat dhe sëmundje të papërcaktuara", që shkaktojnë vdekjen për 20,6 % të grave dhe 14,3 % të burrave dhe 'tumoret', nga të cilët vdesin 12,9 % e grave dhe 19,3 % e burrave.

Analiza sipas grup-moshave për sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut, të cilat janë shkaku kryesor i vdekjeve, tregon diferenca të larta gjinore. Për moshat nën 65 vjeç, numri i vdekjeve të burrave nga këto sëmundje për 100.000 banorë është afërsisht dy herë më i lartë se ai i grave: 84,5 kundrejt 43,9. Për moshat mbi 65 vjeç, ky tregues është pothuajse i barabartë për të dyja gjinitë. Rreth 63,3 % e vdekjeve të burrave nga sëmundjet e qarkullimit të gjakut ndodhin në grupmoshën 65-84 vjeç, kundrejt 57,4 % të vdekjeve të grave të kësaj grup-moshe. Nga ana tjetër, në moshat më të mëdha se 85 vjeç ndodhin rreth 19,5 % e vdekjeve të burrave, kundrejt 33,2 % të vdekjeve të grave.

Në vitin 2019, numri i vetëvrasjeve të burrave është më i lartë se numri i vetëvrasjeve të grave, përktësisht 66,2 % burra dhe 33,8 % gra. Numri i vetëvrasjeve të grave, në vitin 2019, shënoi një rritje prej 3,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018.

Abortet

Ka dy kategori abortesh, spontane dhe të provokuara. Aborti i provokuar është një veprim i ndërmarrë me qëllim për të ndërprerë barrën kryesisht për arsye shëndetësore. Të gjitha abortet e tjera konsiderohen spontane. Numri i aborteve në vitin 2019 ishte 5.183. Abortet spontane mbajnë peshën më të madhe të aborteve duke përbërë 83,9 % të totalit, në vitin 2019.

Në vitin 2019, për çdo 1.000 lindje të gjalla ka patur 181 aborte. Raporti lindje-abort tregon se për çdo 5,5 lindje, ka ndodhur paralelisht edhe një abort.

Health

The health statistics based on the "ICD-9" international classification of causes of death, display detailed data on sex differences regarding health, such as: abortions, causes of death, HIV/AIDS morbidity etc.

Causes of death

The main causes of death for both women and men remain "cardiovascular system diseases", which cause 55.9% of women deaths and 51.1 % of men deaths. Two other important causes are "unspecified symptoms, signs and diseases", which cause 20.6 % of women deaths and 14.3 % of men deaths, as well as "tumours", which cause 12.9 % of women deaths and 19.3 % of men deaths.

The age group analysis on cardiovascular system diseases, which are the main causes of death, reveals high sex differences for people under 65 years of age, in which the number of men deaths per 100,000 people is approximately two times higher than women deaths, specifically 84.5 (men) and 43.9 (women). For people over 65 years of age, this indicator is nearly equal for both sexes. Approximately 63.3 % of men deaths and 57.4 % of women deaths caused by cardiovascular system diseases occur at 65-84 years of age. On the other hand, for people older than 85 years of age, men deaths are 19.5 %, while women death is 33.2 %.

The number of men suicides for 2019 is higher than that of women's. The percentage of women suicides for 2019 was 33.8 %, 3.3 percentage points higher compared to 2018.

Abortion

There are two categories of abortion: spontaneous and induced. Induced abortion is mainly caused by an action, aiming to end the pregnancy. All other abortions are considered to be spontaneous. The number of abortions in 2019 is 5183. Spontaneous abortions are the most common type, and in 2019 marked a rate of 83.9 % from the total number of abortion. In 2019, for every 1.000 live births there were 181 abortions. Birth-abortion ratio shows that for 5.5 live births, there is also one abortion.

Pjesa më e madhe e aborteve kryhen nga gratë e grup-moshës 20-34 vjeç, e cila është dhe grup-mosha më riprodhuese e gruas.

Raporti i abortit për grup-moshën 15-19 vjeç është analizuar në mosha teke, ku në moshën 16 vjeçare kemi vlerën më të lartë të këtij treguesi: 132 aborte për 1.000 lindje të gjalla.

Në vitin 2019, nisur nga niveli arsimor i nënës, numri më i lartë i aborteve është kryer nga gratë me nivel arsimor 9 vjeçar dhe të mesëm, duke zënë një peshë përkatësisht me 34,8 % dhe 25,6 %. Peshën më të vogël e zënë gratë me nivel arsimi fillor (2,6 %), ndërsa përqindja e aborteve nga gratë me nivel arsimor të lartë zë 23,3 % të totalit.

Sipas statusit martesor, 78,2 % e aborteve janë kryer nga gratë e martuara dhe 7,8 % nga gratë beqare. Abortet nga gratë e divorcuara ose të ve janë në nivele shumë të ulëta.

Abortet e kryera nga gratë e papuna ose të pasiguruara, ndër vite, ndjekin të njëjtin trend dhe nivele të përafërta, duke përbërë rreth 55,1 % të aborteve gjithsej. Në vitin 2019, përqindja e aborteve të kryera nga gratë e punësuara shënoi një rritje prej 2,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar.

Most of the abortions happen for women 20 – 34 years old, which is also the most fertile age group.

Abortion rate for the 15-19 years old age group has been analysed for single ages, where 16 year old girls show the highest value for this indicator, 132 abortions for 1000 live births.

Most of the abortions in 2019 were carried by women just with compulsory education and those with secondary education, respectively 34.8 % and 25.6 %. Women with only primary education had the lowest share of the total number of abortions (2.6 %), while women with higher education had 23.3% of the abortions.

According to the civil status, it results that 78.2 % of abortions were carried out by married women, and only 7.8 % by single women. Abortions performed by divorced or widows are at a very low percentage.

Abortions by unemployed or uninsured women, through the years, follow the same trend on nearly equal levels, consisting of over 55.1 % of the total number of abortions. In 2019, the percentage of abortions by employed women increased by 2.1 percentage points.

Sëmundjet seksualisht të transmetueshme HIV/AIDS

Numri i grave dhe burrave të prekur nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme, HIV/AIDS për vitin 2019 është 72 burra dhe 29 gra. Nga 29 gra të prekura, 3 prej tyre ishin shtatëzënë.

Anketa Demografike e Shëndetit, 2017-18 (ADHS) është një anketë përfaqësuese në nivel kombëtar e cila jep një informacion mbi popullsinë dhe çështjet shëndetësore në Shqipëri.

Kjo anketë ofron vlerësime të kohëve të fundit mbi një gamë të gjerë karakteristikash demografike dhe shëndetësore të popullsisë shqiptare. Objektivat e anketës ishin mbledhja e të dhënave në nivel kombëtar dhe rajonal mbi nivelet e fertilitetit dhe përdorimin e kontraceptivëve, shëndetin e nënës dhe fëmijës, shëndeti i të rriturve, HIV, AIDS dhe infeksione të tjera të transmetuara seksualisht (STI); si dhe shëndetin e të rriturve. Anketa mori informacion të detajuar mbi këto tema nga gratë e moshës riprodhuese (mosha 15-49 vjeç) dhe gjithashtu 49-59 vjeç. Për disa tema u sigurua informacion nga meshkujt 15-59 vjeç. Në përgjithësi, anketa ofron vlerësime për një sërë treguesish demografikë dhe shëndetësorë.

Sexually transmitted diseases (STD)

The number of women and men with the sexually transmitted disease HIV/AIDS, in 2019 was 72 men and 29 women. Out of the 29 women with HIV/AIDS only 3 of them were pregnant.

Albania Demographic and Health Survey (ADHS) is a nationally representative sample survey designed to provide information on population and health issues in Albania.

The 2017-18 ADHS provides recent estimates on a wide range of demographic and health characteristics of the Albanian population. The objectives of the ADHS were to collect national and regional level data on fertility levels and contraceptive use; maternal and child health; adult health; HIV, AIDS, and other sexually transmitted infections (STIs); as well as adult health. The survey obtained detailed information on these topics from women of reproductive age (age 15-49) and also age 49-59 and, for certain topics, from men age 15-59 as well. Overall, the survey provides estimates for a variety of demographic and health indicators.

Duhan pirja

Duhanpirja ka një ndikim të konsiderueshëm negativ mbi shëndetin e popullatës. Konsumi i duhanit është një nga shkaktarët kryesor i sëmundjeve kardiovaskulare si dhe i disa kancerave, kryesisht kancerit të mushkërive, etj. Duhanpirja sipas grup-moshave, për vitet 2017-18, evidenton qartë se janë meshkuj ata që zënë peshën kryesore në pirjen e duhanit, në Shqipëri. Pirja e duhanit është më e zakonshme në moshën 30-34 vjeç, në të dy gjinitë: meshkujt me 45,1 % dhe gratë 7,3 %.

Përdorimi i alkoolit

Abuzimi me alkoolin është një problem serioz i cili në vetvete mbart një rrezik të madh në shëndetin e popullatës, si dhe shumë probleme familjare, sociale dhe të punësimit. Diferencat gjinore në konsumin e alkoolit tregojnë se burrat janë ata që me rritjen e moshës kanë një tendencë për të konsumuar më shumë alkool në raport me gratë.

73,4 % e të intervistuarve gra dhe 38,3 % e burrave raportojnë se nuk pijnë alkool, ndërsa te gratë vetëm 23,0 % e tyre deklarojnë se pijnë alkool 1 deri në 3 ditë në muaj ose më pak, kundrejt burrave me 31,8 %.

Konsumimi i frutave dhe zarzavateve në ditë sipas gjinisë

Kërkimet tregojnë se konsumi i rregullt i frutave dhe perimeve shoqërohet me rreziqe të reduktuara të kancerit, sëmundjeve kardiovaskulare, goditje në tru etj. Rekomandohet që një person të konsumojë tri ose më shumë racione të frutave dhe katër ose më shumë racione të perimeve çdo ditë. (Departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Njerëzore 2018).

Pak më shumë se 80 % e burrave dhe grave kanë konsumuar 1 deri në 3 racione perime në ditë, por vetëm 6,8 % e grave dhe 2,6 % e meshkujve konsumojnë numrin e rekomanduar të perimeve (3 ose më shumë) gjatë ditës. 36,1 % e grave dhe 14,0 % e burrave kanë konsumuar sasinë e rekomanduar të frutave (tre ose më shumë racione) në ditë.

Indeksi i masës trupore

Indeksi mesatar i masës trupore (BMI) është 25,4 për gratë 15-49 vjeç dhe 44,6 për burrat. Rreth 41,5 % e grave kanë një peshë normale, ndërsa 24,4 % janë obeze; mbipeshë rezultojnë 41,7 % e burrave dhe 30,8 % e grave.

Smoking

Smoking has also a strong negative impact on population health. Smoking consumption is a known factor for the cardiovascular diseases, causes lung cancer, etc. Regarding smokers by age group 30-34 year for both and sex, for men are 45.1 % and women 7.3 %.

Alcohol

Alcohol abuse is a very serious problem which brings a high risk to public health, as well as much family, social and employment problems. Gender differences in alcohol consumption shows that men are those with increasing age have a tendency to consume more alcohol compared to women.

73.4 % of women interviewed and 38.3 % of men reported that they did not drink alcohol. While women only 23.0 % declare they drink alcohol 1 to 3 days a month or less compared to men by 31.8 %.

Consumption of fruit and vegetables per day by sex

Research shows that regular consumption of fruits and vegetables is associated with reduced risk of cancer, cardiovascular disease, stroke, and so on. It is recommended that a person should eat three or more portions of fruit and four or more portions of vegetables each day. (American Department of Health and Human Services 2018).

Just over 80% of men and women have consumed 1 to 3 portion of vegetables per day, but only 6.8 % of women and 2.6 % of men consume the recommended number of vegetables (3 or more) during the day. 36.1 % of women and 14.0 % of men have consumed the recommended amount of fruit (three or more portions) per day.

Body mass index

The average body mass index (BMI) is 25.4 for women 15-49 years and 44.6 for men. About 41.5 % of women have a normal weight, while 24.4 % are obese. Overweight are 41.7 % of men and 30.8 % of women.

Ushtrimeve aerobike

Në përgjithësi, 11,1 % e grave të moshës 15-59 vjeç raportojnë se bëjnë një formë të stërvitjes aerobike 5 deri në 7 ditë në javë; 3,3 % bëjnë këto ushtrime 3 ose 4 ditë në javë, 3,0 % bëjnë ato 1 ose 2 ditë në javë dhe 82,7 % nuk bëjnë ushtrime aerobike fare. Ndër meshkujt të së njëjtës moshë, 10,4 % ushtrojnë 5-7 herë në javë, 5,9 % ushtrojnë 3 deri 4 herë në javë dhe 77,2 % nuk bëjnë asnjë lloj stërvitjeje aerobike.

Aerobic exercises

Overall, 11.1 % of women aged 15-59 years reported making a form of aerobic exercise 5 to 7 days a week, 3.3 % do these exercises three or four times a week, 3.0 % make them 1 or 2 once a week and 82.7 % do not do aerobic exercises at all. Among men of the same age, 10.4 % exercise 5-7 times a week, 5.9 % exercise 3 to 4 times a week and 77.2 % do no aerobic exercise.

Shkaqet e vdekjeve sipas gjinisë për 100.000 banorë, 2019

Causes of death by sex per 100,000 inhabitant, 2019

Grupsëmundjet	<65		65+		Gjithsej-Total		Disease groups of deaths
	Burra-Men	Gra-Women	Burra-Men	Gra-Women	Burra-Men	Gra-Women	
	2019	2019	2019	2019	2019	2019	
Sëmundje infektive e parazitare	1.3	0.3	2.5	3.3	1.5	0.8	Infectious and parasitic diseases
Tumoret	57.7	42.3	786.6	374.8	159.4	91.8	Tumors
Sëmundjet endokrinë të ushqyerit	2.1	1.1	60.9	52.6	10.3	8.7	Endocrine Disease of Nutrition
Sëmundjet e gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	0.4	0.7	7.0	5.2	1.3	1.4	Diseases of lood and blood forming organs
Sëmundje mendore	0.9	0.9	27.2	27.7	4.6	4.9	Mental illness
Sëmundje e sistemit nervor qëndror dhe organeve të shqisave	4.2	3.3	54.9	42.3	11.2	9.1	Diseases of the central nervous system and the organs of the senses
Sëmundje e aparatit të qarkullimit	84.5	43.9	2509.8	2417.3	422.6	397.5	Diseases of the bloodstream
Sëmundje e aparatit të frymëmarjes	5.1	3.0	133.9	74.2	23.0	13.6	Respiratory diseases
Sëmundje e aparatit të aparatit të tretjes	6.4	1.1	49.3	20.7	12.4	4.0	Diseases of the digestive tract
Sëmundje të organeve urogenitale	1.7	2.2	67.9	43.7	10.9	8.4	Diseases of the urogenital organs
Ndërlikime në barrë,të lindjes dhe te periudhës së paslindjes	5.2	3.9	0.0	0.0	4.5	3.4	Complications of burden, birth and postnatal period
Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në qelize	0.1	0.1	0.0	0.5	0.1	0.1	Diseases of skin and skin tissue disorders in the skin
Sëmundje ë sistemit të kockave dhe te kyceve	0.2	0.2	1.0	4.2	0.3	0.8	Diseases of the bone and joint system
Anomali të bashkëlindura	1.2	0.8	0.0	0.0	1.1	0.7	Congenital anomalies
Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes	4.0	2.6	0.0	0.0	3.4	2.2	Diseases that occur in the period around birth
Simptoma shenja dhe sëmundje të papërcaktuara	21.0	6.0	716.1	948.2	117.9	146.4	Symptoms, signs and diseases not well defined
Dëmtime traumatike	35.8	13.3	81.5	36.6	42.2	16.8	Traumatic damage and poisoning

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, INSTAT

Source: General Directorate of Civil Office, INSTAT

Shpërndarja e vdekjeve sipas gjinisë dhe grup sëmundjeve kryesore në %, 2019

Distribution of deaths by sex and major disease groups in %, 2019



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

Source: General Directorate of Civil Office

Vdekjet nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, sipas moshës dhe gjinisë, 2019
Deaths from diseases of the blood circulation system, by age and sex, 2019



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Numri i vetëvrasjeseve sipas gjinisë
Number of suicide by sex



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Lindjet dhe abortet
Live births and abortions

Vitet Years	Lindje Live births	Aborte Abortions	Raporti i abortit Abortion rate	Lidhja: Lindje/ Aborte The Relation: Births/Abortions
2015	32.715	5.880	180	5.6 :1
2016	31.733	5.410	170	5.9 :1
2017	30.869	5.279	171	5.8 :1
2018	28.934	5.532	191	5.2 :1
2019	28.561	5.183	181	5.5 :1

Burimi: INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP)
Source: INSTAT, Albanian Civil Office, Institute of Public Health (IPH)
Shënim: Përditësim sipas të dhënave më të fundit nga (ISHP)
Note: According to the last data updates by (IPH)

Lindjet dhe abortet
Live births and abortions



Burimi: INSTAT
Source: INSTAT

Numri i aborteve dhe përqindja e aborteve të kryera sipas llojit

The number and percentage of executed abortions according to the kind of abortion



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Source: Institute of Public Health

Përqindja e aborteve sipas grup-moshës së gruas

Percentage of abortions by age group of woman



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik

Source: Institute of Public Health

Numri i aborteve dhe lindjeve sipas moshës së gruas
Abortion and births number by age of woman

Mosha e vajzave Age of woman	2018			2019		
	Numri i aborteve Number of abortion	Numri i lindjeve Number of births	Raporti abortit Abortion rate	Numri i aborteve Number of abortion	Numri i lindjeve Number of births	Raporti abortit Abortion rate
15	1	54	19	2	39	51
16	8	100	80	12	91	132
17	17	236	72	17	208	82
18	69	422	164	52	399	130
19	90	696	129	74	656	113

Raporti i abortit për 1.000 lindje
Abortion rate for 1,000 births



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik
Source: Institute of Public Health

Përqindja e aborteve sipas viteve dhe shkallës arsimore të gruas
Percentage of abortions by year and education level of woman

Niveli arsimor i gruas	Vitet-Years							Education level of woman
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	
Fillor	3,2	3,8	3,7	3,6	3,1	2,5	2,6	Basic or less
9- vjeçar	50,1	48,9	44,8	41,8	31,0	32,4	34,8	Primary
I mesëm	31,7	29,1	32,6	34	30,1	25,7	25,6	Secondary Vocation
I lartë	13,7	15,2	16,4	18,5	17,7	20,3	23,3	University
Pa deklaruar	1,3	3	2,5	2,1	18,1	19,2	13,7	Not declaring



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik
Source: Institute of Public Health

Përqindja e aborteve sipas statusit martesor të gruas
The percentage of abortions by marital status of women

Vitet Year	Statusi martesor i gruas - Marital status of women				
	Beqare Single	E martuar Married	E ndarë Separated	Widow E Ve	Mungon Missing
2013	6,3	92,8	0,6	0,1	0,2
2014	6,0	92,4	0,5	1,0	0,1
2015	5,8	93,1	0,7	0,4	0,0
2016	5,7	92,3	0,8	0,1	1,1
2017	6,3	92,0	0,8	0,2	0,7
2018	6,8	90,5	0,9	0,1	1,7
2019	7,8	78,2	0,9	0,1	13,0

Përqindja e aborteve sipas statusit martesor të gruas, 2019
The percentage of abortions by marital status of women. 2019



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik
Source: Institute of Public Health

Përqindja e aborteve sipas statusit të punësimit dhe sigurimeve shëndetësore të gruas
The percentage of abortions by the status of employment and health insurance of women



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik
Source: Institute of Public Health

Shpeshtësia e HIV/AIDS-it sipas viteve dhe gjinisë (SDG 3.3.1)
Incidence of HIV/AIDS by years and sex (SDG 3.3.1)

Vitet Years	Numër-Number		%	
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women
2013	83	41	66,9	33,1
2014	63	21	75,0	25,0
2015	74	29	71,8	28,2
2016	105	23	82,0	18,0
2017	69	25	73,4	26,6
2018	76	26	74,5	25,5
2019	72	29	71,3	28,7



Burimi: Instituti i Shëndetit Publik
Source: Institute of Public Health

Duhanpirës sipas grup-moshave dhe gjinisë
Tabacco smokers by age group and sex



Burimi: Anketa Demografike e Shëndetit 2017-18
Source: Health Demographic Survey 2017-18

Përdorimi i alkoolit në (%)
The alcohol consumption in (%)

Grup-mosha-Age group	Nuk kanë pirë 12 muajt e fundit Did not drink in the last 12 months		Pinë alkool Drink alcohol	
	Burra-Men	Gra-Women	Burra-Men	Gra-Women
15-19	68,9	80,0	31,1	20,0
20-24	48,1	64,8	51,9	35,2
25-29	32,2	71,0	67,8	29,0
30-34	33,1	67,1	66,9	32,9
35-39	27,0	71,6	73,0	28,4
40-44	32,3	72,6	67,7	27,4
45-49	31,9	73,6	68,1	26,4

Pëdorimi i alkoolit te gratë
Consumption of alcohol, women



Përdorimi i alkoolit te burrat
Consumption of alcohol, men



Burimi: Anketa Demografike e Shëndetit 2017-18
Source: Health Demographic Survey 2017-18

Konsumimi i frutave dhe zarzavateve në ditë sipas gjinisë
Consumption of fruits and vegatables per day

Shpeshtësia e konsumit të frutave	Fruta-Fruits		Zarzavate-Vegatables		Frequency of servings of fruit
	Burra-Men	Gra-Women	Burra-Men	Gra-Women	
Asnjëherë	12,8	8,2	13,6	9,7	None
1 ose 2	71	54,5	81,1	82,7	1 or 2
3 ose më shumë	14,0	36,1	2,6	6,8	3 or more
Smë kujtohet	2,3	1,2	2,7	0,8	Do not recall

Konsumi i frutave në ditë
Consumption of fruits per day



Konsumi i zarzavateve në ditë
Consumption of vegatables per day

Burimi: Anketa Demografike e Shëndetit 2017-18
Source: Health Demographic Survey 2017-18

Indeksi i masës trupore
Body mass index



Burimi: Anketa Demografike e Shëndetit 2017-18
Source: Health Demographic Survey 2017-18

Numri i ushtrimeve aerobike të ushtruara në ditë gjatë një jave
Practice of aerobic exercises number of days per week

Numri i ditëve për javë	Burra-Men	Gra-Women	Number of days per week
Nuk ushtrojnë aktivitet fizik	77,2	82,7	Does not exercise
1 ose 2	6,5	3,0	1 or 2
3 ose 4	5,9	3,3	3 or 4
5 deri në 7	10,4	11,1	5 to 7



Burimi: Anketa Demografike e Shëndetit 2017-18
Source: Health Demographic Survey 2017-18

Arsimi

Education



Të diplomuar në arsimin e lartë
Graduated in tertiary education

40,3 %

59,7 %

Vitet - Years
2018-19

Trupi mësimor në arsimin e lartë 2019
Academic staff in teriary education education

Profesorë Professors	Doktorë Phd	Docentë dhe Pedagogë pa titull Docents and pedagogues without titles
Burra-Men 59,3 %	Burra-Men 40,2 %	Burra-Men 39,5 %
Gra-Women 40,7 %	Gra-Women 59,8 %	Gra-Women 60,5 %

Arsimi

Statistikat e arsimit në këtë botim paraqesin të dhëna mbi pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve, duke filluar nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë, të atij publik dhe jo publik, si dhe stafet mësimdhënëse sipas niveleve arsimore.

Sistemi arsimor në vend kërkon që e gjithë popullsia banuese të përfundojë arsimin bazë prej nëntë vitesh, duke përfshirë këtu pesë vitet e ciklit të ulët (Klasa 1-5) dhe katër vite (Klasa 6-9) në ciklin e lartë si pjesë e arsimit bazë. Ndërkohë, baza ligjore garanton aksesin në arsim të të gjithë popullsisë.

Pjesëmarrja në arsim sipas niveleve arsimore

Duke analizuar pjesëmarrjen në arsim sipas nivelit (GER), gjatë vitit akademik 2018/19 vihet re se rreth 80,3 % e fëmijëve djem dhe 76,3 % e vajzave shkojnë në kopësht pa diferenca gjinore. Niveli i pjesëmarrjes bruto në arsimin e detyrueshëm është 102,6 % për djemtë dhe 97,2 % për vajzat. Edhe pjesëmarrja në arsimin e mesëm është më e lartë për djemtë se për vajzat, përkatësisht 99,3 % dhe 91,7 %, ndërsa në nivelin universitar raporti përmbyset, ku pjesëmarrja është më e lartë për vajzat, me 71,8 % sesa për djemtë, me 48,7 %.

Pjesëmarrja sipas gjinisë në ciklet arsimore tregon për ekzistencën e diferencave gjinore në nivelet e ndryshme të arsimit. Ka një raport më të lartë të djemve krahasuar me vajzat në arsimin parauniversitar ndërkohë që në arsimin e lartë 59,7 % e studentëve të këtij cikli janë vajza. Kjo reflektohet dhe në indeksin e barazisë gjinore (mbi GER) që për arsimin e lartë ka vlerën 1,48.

Të diplomuarit

Të diplomuarit e vitit shkollor 2018/19 në arsimin e detyruar ishin rreth 35 mijë nxënës nga të cilët 52,6 % ishin djem dhe 47,4 % vajza. Në këtë vit shkollor u diplomuan në arsimin e mesëm rreth 34 mijë nxënës, ku vihet re një ulje e vogël e numrit të nxënësve që marrin diplomë krahasuar me vitin paraardhës. Nxënësit e diplomuar në arsimin e mesëm sipas gjinisë ishin 47,9 % djem dhe 52,1 % vajza.

Numri i të diplomuarve në arsimin e lartë në vitin akademik 2018/19 ishte afërsisht 35 mijë studentë ndër të cilët vajzat përbënin 66,4 %. Numri i të diplomuarve vajza në krahasim me një vit më parë është rritur me 6,6 %.

Education

Education statistics in this publication present data on girls and boys, as well as academic staff participation at all levels of education, in both formal and informal.

The education system in the country requires to the residing population to complete the basic 9-year education, including the primary (1-5 grade) and the lower secondary (6-9 grade) education. In the meantime, the legal basis guarantees access to education of all population from Ministry of Education, Sports and Youth, the duty of which is to ensure equal opportunities.

Educational participation by education levels

From the analysis conducted on educational participation by levels (GER), it is noted that approximately 80.3 % of male children and 76.3 % of female children are enrolled in kindergarten with no gender differences. The compulsory enrollment rate is 102.6 % for boys and 97.2 % for girls. Participation in the upper secondary education is higher for boys than girls, namely 99.3 % and 91.7 %, whereas the ratio for higher education is rather reversed, as the participation scores higher for girls 71.8 % than boys 48.7 %.

Educational participation by gender in the education cycles indicates the existence of gender differences at various education levels. The ratio of boys attending pre-university education is higher compared to girl's, whereas 59.7 % of students in higher education are girls. This is reflected in the gender equality index (GER), amounting to 1.48 for higher education.

Graduates

During the school year 2018/2019, in the compulsory education were successfully graduated around 35 thousand students, of which 52.6 % were boys and 47.4 % girls. This school year was marked by a slight decrease in the number of students obtaining an upper secondary education degree, compared to the previous year. Students graduated upon completion of upper secondary education by gender were 47.9 % boys and 52.1 % girls.

The number of graduates from higher education in the academic year 2018/2019 amounted to 35 thousand students, of whom 66.4 % were girls. The number of graduate girls decreased by 6.6 % compared to the previous year.

Trupi mësimor sipas niveleve arsimore

Në vitin shkollor 2018/2019, në trupin mësimor të arsimit parauniversitar mbizotërojnë gratë, përkatësisht 74,6 % në arsimin 9 vjeçar dhe 66,5 % në arsimin e mesëm. Në trupin akademik të arsimit të lartë mbizotërojnë burrat, përqindja e tyre rritet me rritjen e gradës në trupin akademik. Gratë me titull Profesor janë 40,7 %, ato me titull Doktor janë 59,8 % dhe Docentë dhe Pedagogë pa tituj janë 60,5 %, krahasuar me burrat.

Peshën kryesore në diplomat e marra sipas fushave të studimit në arsimin e lartë, e zë ajo e shkencave të biznesit, administrimit dhe ligjit, për të dyja gjinitë.

Gratë preferojnë të studiojnë dhe diplomohen më shumë në biznes, administrim dhe ligj (27,1 %), shëndet dhe mirëqënie (18,4 %) dhe arsim (13,1 %). Ndërsa burrat preferojnë të studiojnë dhe diplomohen më shumë në fushën biznes, administrim dhe ligj (29,3 %), inxhinieri, prodhim dhe ndërtim (17,5 %), shëndet dhe mirëqënie (9,6 %).

Fusha e studimit, më e dominuar nga gratë e diplomuara është arsim (81,4 %), ndjekur nga fusha e shëndetit dhe mirëqenies (79,1 %), dhe arte dhe shkenca humane (78,2 %). Ndërsa burrat dominojnë më shumë në fushën e shërbimeve (73,6 %), ndjekur nga inxhinieri, prodhim dhe ndërtim (62,6 %), si dhe bujqësi, pyje, peshkim dhe vetenari me 55,1 %.

Gratë mbi 65 vjeç me arsim bazë zënë 76,2 % ndërkaq burrat 56,8 %. Vetëm 5,5 % e grave në këtë grup-moshë janë me arsim të lartë, kundrejt 13,0 % të burrave. Në popullsinë 25-39 vjeç, gratë me arsim të lartë përbëjnë 37,7 % ndërsa burrat 25,8 %. Në këtë grup-moshë, 42,7 % e grave janë me arsim bazë, ndërsa tek burrat kjo përqindje është 37,9 %.

Academic body by education levels

In 2018/2019, the academic body in the primary and secondary education was preponderantly composed of women, namely 74.6 % and 66.5 % of teachers in each level. Men prevail in the higher education, whose percentage towards women increases upon obtaining higher academic titles. Women holding the title Professor amount to 40.7 %, women holding the title Doctor amount to 59.8 %, whereas women Docents and Lecturers are as high as 60.5 % compared to men.

The majority of diplomas were obtained in the following fields of study for both genders: business sciences, administration, and law.

Fields of study women graduate the most are business, administration, and law (27.1%); health and wellbeing (18.4 %); arts, and education (13.1 %). On the other hand, the fields of study men graduate the most are business, administration, and law (29.3 %); engineering, manufacturing, and construction (17.5 %); and health and wellbeing (9.6 %).

The most pursued field of study by graduated females is the field of education sciences, in which 81.4 % of graduated students are girls, followed by health and wellbeing with 79.1 % of women graduates, and arts, and human sciences (78.2 %). Meanwhile men prevail in the field of services (73.6 % of graduates are boys), followed by engineering, manufacturing, and construction (62.6 %), and agriculture, forestry, fisheries and veterinary (55.1 %)

Women older than 65 years old that have completed the basic education amount to 76.2 %, whereas men to 56.8 %. Only 5.5 % of women belonging to this age group have completed the higher education, compared to 13.0 % of men. For the 25-39 years old population, 37.7 % of women have completed the higher education compared to 25.8 % of men. For the same age group, 42.7 % of women have completed the basic education, as compared to 37.9 % of men.

Studentë me aftësi të kufizuar sipas cikleve mësimore

Për vitin akademik 2018/19, përqindja e vajzave ndaj nxënësve me aftësi të kufizuar në arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm është më e ulët se ajo e djemve, 33,2 % dhe 39,2 %, ndërsa në arsimin e lartë është 58,4 %.

Pjesëmarrja më e lartë e studentëve me aftësi të kufizuar për vitin akademik 2018/19 është në Universitetin e Elbasanit, ku janë regjistruar 51,7 % e vajzave dhe 42,4 % e djemve me aftësi të kufizuar. Në Universitetin e Vlorës, Durrësit, Tiranës, Shkodrës dhe

Students with disabilities by education level

For the academic year 2018/2019, the ratio of girls out of the disabled students' in the 9-year education system and upper secondary education is lower than boys', namely 33.2 % and 39.2 %, whereas the figure for higher education is as high as 58.4 %.

Higher participation of students with disabilities for the academic year 2018/2019 is noted in the University of Elbasan, in which 51.7 % of women's and 42.4 % of men's with disabilities have been enrolled.

Elbasanit, pjesëmarrja e vajzave me aftësi të kufizuar është më e lartë se ajo e djemve.
Burimi i të dhënave administrative për statistikat e arsimit është nga MASR (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë) dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

In the University of Vlora, Durrës, Tiranë, Shkodër and Elbasan, the participation of disabled girls is higher compared to men's. The administrative data source for education statistics is from Ministry of Education, Sports and Youth and Ministry of Finance and Economy.

Nxënës në shkolla sipas programit dhe gjinisë

Pupil in schools by programmes and sex

Programi	2013-14		2014-15		2015-16		2016-17		2017-18		2018-19		Programme
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	
	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	
Parashkollor	42.677	38.771	43.266	39.228	43.242	39.891	42.295	38.899	42.314	38.712	41.221	37.721	Pre-Primary
Fillore	103.111	92.609	99.627	88.744	94.737	84.827	92.380	82.456	89.835	81.026	87.762	79.342	Primary
Cikli i lartë i 9 vjeçares	95.359	85.995	91.873	83.164	86.554	77.381	80.842	72.422	78.348	70.462	73.705	65.721	Lower secondary
Mesme	83.636	69.301	75.548	64.494	69.219	61.161	67.528	59.586	63.901	56.161	62.177	54.469	Upper secondary

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Pjesëmarrja në arsim sipas niveleve arsimore / raporti i regjistrimit bruto

Participation in education by education level /gross enrolment ratio (GER)

	2013-14		2014-15		2015-16		2016-17		2017-18		2018-19	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls	Boys	Girls
Parashkollor/ Pre-Primary	80,3	79,8	82,3	82,3	83,3	83,3	81,8	81,3	81,6	78,9	80,3	76,3
9 vjeçare/Primary+Lower Secondary	103,3	101,0	104,0	101,9	102,8	100,8	101,6	99,2	102,1	99,2	102,6	97,2
I mesëm/Upper secodary	106,5	93,3	102,3	91,4	96,7	89,6	98,0	91,1	97,4	90,1	99,3	91,7
I lartë/Tertiary	55,2	75,0	52,0	70,9	47,2	68,2	45,4	68,6	43,8	66,4	48,7	71,8

Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Pjesëmarrja në arsim sipas niveleve arsimore / rapoti i regjistrimit bruto

Participation in education by education level /gross enrolment ratio(GER)



Burimi: INSTAT

Source: INSTAT

Indeksi i Barazise Gjinore (mbi GER)
Gender Parity Index (on GER)

Gender Parity Index (on GER)							
3. Since age 15, a non-partner forced you into sexual intercourse when you did not want to, for example by threatening you, holding you down or putting you in a situation where you could not say no
4. Since age 15, forced you to have sex when you were too drunk or drugged to refuse

II. Varfëria relative dhe përjashtimi social

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) siguron të dhëna në fushën e varfërisë relative, përjashtimit social, të ardhurave dhe nivelit të jetesës në vend. Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për një person në vitin 2018 është vlerësuar 160.742 Lekë, krahasuar me 145.017 lekë që ishte në vitin 2017. Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri në vitin 2018 është 23,4 %. Në vitin 2017, ky tregues ishte 23,7 %, duke pësuar një rënie me 0,3 pikë përqindje.

Shkalla e thelluar e privimit material është vlerësuar 38,3 % në vitin 2018, kundrejt 41,1 % e vlerësuar në vitin 2017, duke shënuar një rënie me 2,8 pikë përqindje. Individët e grup-moshës 18-59 vjeç të cilët jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim, në vitin 2018 sipas vlerësimeve përbëjnë 13,3 % duke pasqyruar një rënie me 1,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2017.

Tregues social nga Anketat në Familje në vitin 2018, rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social është 49,0 %. Kjo shifër është ulur me 2,8 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2017. Vajzat dhe gratë paraqesin rrezik më të lartë për të qenë të varfër ose përjashtimi social krahasuar me burrat përgjatë dy viteve të vrojtuara dhe në të gjitha kategoritë përcaktuese të rrezikut për të qenë i varfër ose përjashtimit social.

Nivelin më të lartë të rrezikut për të qenë i varfër e hasim tek kategoria e të papunëve për të dyja vitet e vrojtura. Burrat e papunë paraqesin rrezik më të lartë për të qenë të varfër se gratë e papuna.

Rrezikshmërinë më të lartë të varfërisë e hasim tek grup-mosha 0-17 vjeç për të dyja vitet e vrojtuara. Vajzat dhe gratë paraqesin rrezik më të lartë për të rënë në varfëri se burrat.

Vetë-perceptimi i gjendjes shëndetësore dhe nevojat bazë të paplotësuara

Pjesa më e madhe e popullsisë mbi 16 vjeç për vitin 2017 percepton se gjendja e përgjithshme shëndetësore e tyre është shumë e mire ose e mirë. Burrat duket se janë më të vetëkënaqur sesa gratë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore. Ky trend perceptimi ka ardhur në rritje edhe përgjatë vitit 2018.

Për vitin 2018, 21,5 % e popullsisë nuk u është plotësuar nevoja për ekzaminim ose trajtim mjekësor, ku gratë kanë patur nevoja më të mëdha të paplotesuara sesa burrat. Diferenca gjinore në disfavor të grave për paplotësim të nevojave duket të jetë e njëjtë edhe për ekzaminimet dhe trajtimet dentare.

II. Relative poverty and social exclusion

The Income and Living Condition survey (SILC) provides data on relative poverty, social exclusion, income and living condition in the country. At risk of poverty threshold for one person in 2018 was set at 160,742 ALL, compared to 145,017 ALL in 2017. At risk of poverty indicator in Albania in 2018 is 23.4 %. In 2017, this indicator was 23.7%, decreasing by 0.3 percentage points.

Severe material deprivation is estimated at 38.3 % in 2018, against to 41.1 % in 2017, decreasing by 2.8 percentage points. Individuals aged 18-59 living in households with very low work intensity in 2018 are estimated 13.3 %, reflecting a decrease of 1.1 percentage points compared to 2017.

In 2018, at risk of poverty or social exclusion is 49 %. This figure has decreased by 2.8 percentage points compared to 2017. Girls and women present a higher risk of poverty or social exclusion compare to men over the two years surveyed and in all determinants category of at risk of poverty or social exclusion.

The highest level of at risk of poverty is found in the category of the unemployed for two observed years. Unemployed men present a higher risk of poverty than unemployed women.

The highest risk of poverty is found in the age group 0-17 years for both observed years. Girls and women are at higher risk of falling into poverty than men.

Self-perception of health condition and basic unmet need

The majority of the population aged 16 and over for 2017 perceives that their overall health condition is very good or good. Men seem to be more complacent than women about their overall health. This perception trend has been increased during 2018.

For 2018, 21.5 % of the population has unmet needs for medical examination or treatment, where women have greater unmet needs than men. The gender difference in women's disadvantage for meeting needs seems to be the same for dental examinations and treatments.

III. Njësitë ekonomike familjare dhe shpenzimet për konsum

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF). Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB-së me metodën e shpenzimeve.

Nga të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjeve, rezulton se në vitin 2018 kishte 772.664 NjEF në Shqipëri, prej të cilave 84,5 % me kryefamiljarë burra dhe 15,5 % me kryefamiljare gra. Sipas anketës, gratë kryefamiljare janë më shumë prezente sesa burrat në tipologjinë e familjes "person i vetëm", numri i tyre është 2,6 herë më i madh se ai i burrave. Numri i grave që jetojnë të vetme me fëmijët e tyre është më i lartë se numri i burrave në të njëjtat kushte, për të gjitha gru-pmoshat.

Në Shqipëri, njësitë ekonomike familjare me kryefamiljarë burra janë 5,5 herë më shumë se familjet me kryefamiljare gra. Grup-mosha 55-64 vjeç paraqet numrin më të lartë të familjeve me kryefamiljarë burra, dhe grup-mosha 65-74 vjeç për gratë.

Në vitin 2018, shpenzimet mesatare mujore për konsum për një NjEF janë 75.935 lekë. Ushqimet dhe pijet jo-alkoolike përbëjnë grupin kryesor të konsumit për familjet shqiptare, me një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 33.436 lekë. Për këtë grup konsumi, gratë kryefamiljare shpenzojnë 47,0 % dhe burrat kryefamiljar 43,6 % të buxhetit të tyre. Gratë kryefamiljare duket se shpenzojnë më shumë edhe për shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar, krahasuar me burrat të cilët kanë një tendencë shpenzimesh më të lartë sesa gratë në transport, restorante dhe hotele.

III.Household economic units and consumption expenditure

The Household Budget Survey is a statistical survey which is carried out at the household level and gives an overview of the socio-economic situation of the Albanian households. The results of this survey are also used to update the Consumer Price Index and Final Consumption calculation households as an important aggregate of GDP by the expenditure method.

From the Household Budget Survey data, it results that in 2018 there were 772.664 HUs in Albania, of which 84.5 % were headed by men, while 15.5 % by women. According to the survey, women heads of households are more present than men in the family typology "Lone person"; their number is 2.6 times higher than that of men. The number of women living alone with their children is higher than the number of men in the same conditions, for all age groups.

In Albania, households headed by men's are 5.5 times larger than households headed by women's. The age group 55-64 year old presents the highest number of families with men heads of households and the age group 65-74 year old for women.

In 2018, the average monthly consumption expenditure per household is 75,935 ALL. Food and non-alcoholic beverages constitute the main consumer group for Albanian households, with an average monthly expenditure value of ALL 33,436. For this consumer group, women heads of households spend 47.0 % and men heads of households 43.6 % of their budget. Women heads of households also seem to spend more on housing, water, electricity, gas and other fuels etc., compared to men who have a higher spending trend than women in transport, restaurants and hotels.

IV. Përdorimi i TIK

Anketa mbi Përdorimin e TIK në Familje dhe nga Individët është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe ka objekt të gjithë individët të grup-moshës 16-74 vjeç me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Të dhënat e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët do të shërbejnë si një nga inputet për llogaritjen e përdorimit të treguesve mbi teknologjitë e përdorura për informacion dhe komunikim nga familjet dhe individët.

IV. Use of ICT's

The Survey on "Information and Communication Technologies usage in Households and by Individuals (ICT)" is a statistical survey which targets are households and all individuals residing in Albania 16 - 74 years old. The survey data will be used as one of the inputs for calculating the indicators on ICT's usage and communication technologies used by households and individuals.

The use of internet in 2019 for the category" in the last three months" from the moment of conducting the interview has recorded an increase by around 6 points percentage compared with 2018, where 71.2 % of men

Përdorimi i internetit në vitin 2019 për kategorinë "gjatë 3 muajve të fundit" nga momenti i kryerjes së intervistës ka shënuar rritje rreth 6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018, ku 71,2 % e burrave dhe 66,0 % e grave të grup-moshës 16-74 vjeç janë përdorues të internetit gjatë 3 muajve të fundit. Rreth 29,1 % e grave nuk e kanë përdorur asnjëherë internetin gjatë këtij viti, përkundrejt 24,1 % burra.

Treguesi mbi shpeshtësinë e përdorimit të internetit për kategorinë "çdo ditë/pothuajse çdo ditë" ka shënuar rritje prej 1,7 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018. Shpeshtësia e përdorimit të internetit sipas ndarjes gjinore, tregon se në vitin 2019 burrat dhe gratë e përdorin internetin "çdo ditë/pothuajse çdo ditë", përkatësisht 88,0 % dhe 86,1 %.

Sa i përket blerjeve nëpërmjet internetit, sipas gjinisë dhe grup-moshave, në vitin 2019 gratë kanë kryer më shumë blerje për veshje/pajisje sportive në krahasim me burrat (56,9 % për gratë dhe 43,1 % për burra), ndërsa burrat treguan një preferencë më të madhe për kompjuter, programe kompjuterike, pajisje kompjuteri, pajisje elektronike (63,3 % përkundrejt 36,7 % për gratë).

and 66.0 % of women aged 16 - 74 years old are internet users. About 29.1 % of women have never used the internet during 2019, compared to 24.1% of men.

In 2019, the indicator of the frequency of internet usage for the category "every day / almost every day" has increased by 1.7 points percentage compared to year 2018. The frequency of internet usage by gender shows that in 2019 men and women use the internet "every day or almost every day", respectively 88.0 % and 86.1 %.

Online purchases by gender and age-groups, in 2019 women bought more clothing/sports equipment than men (56.9 % for women, 43.1 % for men), while men showed a greater preference for computer- related items: software computer, computer equipment, electronic equipment (63.3 % versus 36.7 % for women).

Përjetime të dhunës ndaj grave dhe vajzave, %

Experiences of violence against women and girls

	Ndonjëherë % Ever %	Aktualisht % Current %	
Ka përjetuar dhunë (një ose më shumë se një nga 5 llojet)	**52,9**	**36,6**	**Experienced violence (one or more of the 5 types)**
Ka përjetuar dhunën në familje nga partneri intim	47	33,7	Experienced intimate partner domestic violence
Ka përjetuar dhunë në lidhje dashurie	65,8	61,8	Experienced dating violence
Ka përjetuar dhunë nga jopartneri që nga mosha 15 vjeçare	18,2	2,4	Experienced non-partner violence since age 15
Ka përjetuar ngacmim seksual	18,1	8,5	Experienced sexual harassment
Ka përjetuar përndjekje	12,6	6,9	Experienced stalking

Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Numri i llojeve të dhunës të përjetuar

Number of types of violence experienced



Llojet e dhunës:
Ka përjetuar dhunën në familje nga partneri intim
Ka përjetuar dhunë në lidhje dashurie
Ka përjetuar dhunë nga jopartneri që nga mosha 15 vjeçare
Ka përjetuar ngacmim seksual
Ka përjetuar përndjekje

Violence types:
Experienced intimate partner domestic violence
Experienced dating violence
Experienced non-partner violence since age 15
Experienced sexual harassment
Experienced stalking

Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Niveli i arsimit të autorëve të dhunës në familje

Domestic violence perpetrator's level of education



Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Përjetime të dhunës në familje nga partneri intim, % (SDG 5.2.1)

Experience of intimate partner domestic violence (SDG 5.2.1)

	Ndonjëherë % Ever %	Aktualisht % Current %	
Kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim (një apo më shumë nga 5 llojet)	**47,0**	**33,7**	**Experienced intimate partner domestic violence (one or more of the 5 types)**
Sjellje kontrolluese shtrënguese (një apo më shumë nga 7 llojet)	41,2	25,2	Coercive controlling behaviours (one or more of the 7 types)
Dhunë ekonomike (një apo më shumë nga 3 llojet)	7,0	7,0	Economic violence (one or more of the 3 types)
Dhunë psikologjike (një apo më shumë nga 8 llojet)	31,4	19,7	Psychological violence (one or more of the 8 types)
Dhunë fizike (një apo më shumë nga 11 llojet)	18,0	7,2	Physical violence (one or more of the 11 types)
Dhunë seksuale (një apo më shumë nga 3 llojet)	8,6	3,6	Sexual violence (one or more of the 3 types)
Dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja	21,0	8,2	Physical and/or sexual violence, or both

Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Kampioni sipas moshës i dhunës në familje nga partneri intim, %

Intimate partner domestic violence sample by age, %



Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Kur ka filluar dhuna në familje nga partneri intim, %

When intimate partner domestic violence began, %

Kur filloi dhuna	Ndonjëherë %-Ever % Sjellje kontrolluese Controlling behaviours	Dhunë ekonomike Economic violence	Dhunë psikologjike Psychological violence	Dhunë fizike Physical violence	Dhunë seksuale Sexual violence	When violence began
Përpara martese	1,1	0,4	1	1,2	0	Before marriage
Në vitin e parë	25,7	20,8	25,4	25,7	29,5	≤ 1st year
Në vitin e dytë deri në të tretin	23,3	31,6	23,5	23,4	33,7	2nd to 3rd years
Në vitin e katërt deri në të pestin	15,1	13,5	15,8	14,8	15,4	4th to 5th years
Pas 6 ose më shumë vitesh	17,7	14,4	18	17,5	11,9	6th + years
Nuk e di/refuzim	17,2	19,3	16,3	17,5	9,5	Don't know/refused answer

Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Përjetime të dhunës nga jopartneri që prej moshës 15 vjeçare, % (SDG 5.2.2)

Experiences of non-partner violence since age 15, % (SDG 5.2.2)

Përjetoi dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (një ose më shumë se një nga katër llojet)	Ndonjëherë % Ever %	Aktualisht % Current %	Experienced physical and/or sexual non-partner violence since age 15 (one or more of the 4 types)
	18,2	2,3	
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju ka goditur, goditur me shuplakë, ju ka gjuajtur me shkelma ose ka kryerndonjë veprim tjetër për t'ju lënduar fizikisht (dhunë fizike)	17,3	2,3	Since age 15, a non-partner hit, slapped, kicked or done something else to physically hurt (physical violence)
Përjetoi dhunë seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (një ose më shumë se një nga tre llojet)	**1,3**	**0**	**Experienced sexual non-partner violence since age 15 (one or more of the 3 types)**
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju ka prekur seksualisht kundër dëshirës tuaj ose u përpoq t'ju prekte seksualisht, por nuk ia doli t'ju detyronte të kryenit marrëdhënie seksuale kundër dëshirës tuaj	0	0	Since age 15, a non-partner touched you sexually when you did not want them to or attempted to touch you sexually, but did not succeed at forcing you to have sexual intercourse
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kundër dëshirës tuaj, për shembull duke ju kërcënuar, duke ju mbajtur me forcë, ose duke ju vendosur në një situatë ku nuk mund të kundërshtoni	1,0	0	Since age 15, a non-partner forced you into sexual intercourse when you did not want to, for example by threatening you, holding you down or putting you in a situation where you could not say no
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju detyroi të kryeni marrëdhënie seksuale kur ishit shumë e dehur apo e droguar për të refuzuar	1,1	0	Since age 15, forced you to have sex when you were too drunk or drugged to refuse

Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Normat shoqërore të lidhura me dhunën në familje ndaj gruas nga partneri %

Social norms related to intimate partner domestic violence against women, %

	%	
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se dhuna ndërmjet burrit dhe gruas është një çështje private dhe të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë	**52,2**	**All or most people in the community believe violence between a husband and wife is a private matter and others should not intervene**
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se një grua duhet të durojë njëfarë dhune për ta mbajtur familjen të bashkuar	46,5	All or most people in the community believe a woman should tolerate some violence to keep her family together
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se kur një grua rrihet nga bashkëshorti është pjesërisht faji i saj	27,5	All or most people in the community believe when a woman is beat by her husband that she is partly to blame or at fault
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se gruas duhet t'i vijë turp nëse flet me dikë jashtë familjes së saj për abuzimin apo dhunën në jetën bashkëshortore	27,6	All or most people in the community believe a woman should be ashamed or embarrassed to talk to anyone outside of her family about abuse or violence in her marriage
Të gjithë ose shumica e burrave në komunitetin tuaj godasin apo rrahin ndonjëherë gratë e tyre	13,5	All or most men in the community sometimes hit or beat their wives
Të gjithë ose shumica e burrave në komunitetin tuaj godasin apo rrahin ndonjëherë gratë e tyre nëse ato refuzojnë të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta	11,4	All or most men in the community sometimes hit or beat their wives for refusing to have sexual intercourse

Burimi: Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave, 2018

Source: Violence against Women and Girls, 2018

Rreziku për të qënë i varfër ose përjashtimi social sipas gjinisë (në %)

At Risk of Poverty or Social Exclusion by sex (in %)

Treguesit	2017			2018			Indicators
	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	
Rreziku për të qënë i varfër (%)	23,5	23,9	**23,7**	23,0	23,8	**23,4**	At risk of poverty rate(%)
Intensitet shumë i ulët në punësim (%)	13,6	15,2	**14,4**	12,5	14,0	**13,3**	Low work intensity (%)
Individët thellësisht të privuar materialisht (Mungesa e 4 nga 9 kategoritë e privimit material)(%)	40,6	41,6	**41,1**	37,8	38,8	**38,3**	Severe material deprivation (lack of 4 out of 9 categories of material deprivation) (%)
Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) (%)	51,3	52,3	**51,8**	48,0	49,9	**49,0**	At risk of poverty or social exclusion (AROPE) (%)

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Rreziku për të qenë i varfër sipas statusit të punësimit dhe gjinisë (në %)

At risk of poverty rate by activity status and sex (in %)

Statusi i Punësimit	2017			2018			Activity status
	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	
Të punësuar (18 vjeç e lart)	**18,6**	**16,8**	**17,9**	**16,9**	**15,9**	**16,5**	**Employed (18 years old and over)**
Jo në punësim	**26,8**	**24,3**	**25,3**	**26,6**	**25,1**	**25,7**	**Not employed**
Të papunë	42,0	35,7	38,8	43,5	31,8	37,1	Unemployed
Pensionistë	13,3	13,5	13,4	12,5	15,5	14,2	Retired
Inaktivë - Tjetër	23,5	26,5	25,6	24,2	29,5	27,9	Inactive population - Other

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Rreziku për të qenë i varfër sipas statusit të punësimit dhe gjinisë (në %), 2018

At risk of poverty rate by activity status and sex (in %), 2018



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Rreziku për të qenë i varfër sipas grup-moshës dhe gjinisë (në %) (SDG 1.2.1)

At risk of poverty rate by agegroup and sex (in %) (SDG 1.2.1)

Grupmosha	2017 Burra Men	2017 Gra Women	2017 Gjithsej Total	2018 Burra Men	2018 Gra Women	2018 Gjithsej Total	Agegroup
0-17 vjeç	27,7	31,8	**29,6**	28,7	30,6	**29,6**	0-17 years old
18-64 vjeç	24,0	23,4	**23,7**	23,2	23,3	**23,2**	18-64 years old
65+	13,0	13,7	**13,4**	12,5	15,4	**14,0**	65 and over
Gjithsej	23,5	23,9	**23,7**	23,0	23,8	**23,4**	**Total**

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Rreziku për të qenë i varfër sipas grup-moshës dhe gjinisë (në %)

At risk of poverty rate by agegroup and sex (in %)



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Vetë perceptimi i gjendjes së përgjithshme shëndetësore për individët 16 vjeç e lart (në %)

Self- perceived of general health in individuals 16 years old and above (në %)

Treguesit	2017			2018			Indicators
	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	
	Men	Women	Total	Men	Women	Total	
Shumë mire ose mirë	83,9	78,9	**81,4**	84,1	79,6	**81,8**	Very Good and Good
Disi	11,2	15,3	**13,3**	11,2	14,9	**13,1**	Fair
Keq ose shumë keq	4,9	5,8	**5,3**	4,8	5,5	**5,1**	Bad and Very Bad

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Përqindja e individëve 16 vjeç e lart që kanë patur nevoja të paplotësuara për kujdes mjeksor dhe dentar

Pecentage of persons 16 and over that have unmet need for medical and dental care

Treguesit	2017			2018			Indicators
	Burra	Gra	Gjithsej	Burra	Gra	Gjithsej	
	Men	Women	Total	Men	Women	Total	
Nevojë e paplotësuar për ekzaminim ose trajtim mjeksor	18,1	19,9	**19,0**	19,7	23,3	**21,5**	Unmet need for medical examination or treatment
Nevojë e paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar	20,0	21,0	**20,5**	22,4	24,8	**23,6**	Unmet need for dental examination or treatment

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018

Source: Living Conditions Survey 2017, 2018

Numri i NjEF sipas tipologjisë, madhësisë së NjEF dhe gjinisë së kryefamiljarit, 2018

Number of Housholds by typology, size of household and sex of the head of the household, 2018

Madhësia e NjEF / Household Size											
	Një person / One Person		2 persona / 2 persons		3 persona / 3 persons		4 persona / 4 persons		5+ persona / 5+ persons		
Tipologjia e NjEF	Gjinia e kryefamiljarit / Sex of head of houshold										Houshold Type
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Person i vetëm	16.473	42.356	-	-	-	-	-	-	-	-	Lone person
Person i vetëm me fëmijë në varësi	-	-	*	2.812	-	1.062	*	998	-	-	Lone person with children
Dy të rritur pa fëmijë	-	-	146.397	19.746	-	-	-	-	-	-	Couple without children
Dy të rritur me fëmijë	-	-	-	-	35.208	2.557	58.743	4.171	26.479	1.515	Couple with children
Tre ose më shumë të rritur pa fëmijë	-	-	-	-	79.299	11.074	73.046	4.615	26.367	2.992	Three or more adults without children
Tre ose më shumë të rritur me fëmijë	-	-	-	-	-	-	41.889	6.688	148.718	18.988	Three or more adults with children
Gjithsej	**16.473**	**42.356**	*	**22.557**	**114.507**	**14.693**	*	**16.472**	**201.563**	**23.495**	**Total**

**** Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti./ Hidden values for confidentiality reasons.***

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2018

Source : Household Budget Survey, 2018

(**) dhe (***) ju bëjmë me dije se të dhënat e ABF 2018 janë objekt revizionimi në vitin 2020 për shkak të ndryshimeve metodologjike

(**) and (***) HBS 2018 data are subject to revision in 2020 due to methodological changes

Personat e vetëm dhe personat e vetëm me fëmijë sipas moshës dhe gjinisë së kryefamiljarit 2018

Lone persons and lone persons with kids by age and sex of head of household 2018

Mosha e kryefamilajrit / Age of Head of Household	Burra / Men		Gra / Women	
	Person i vetëm Lone person	Person i vetëm me fëmijë në varësi Lone person with children	Person i vetëm Lone person	Person i vetëm me fëmijë në varësi Lone person with children
Nën 25 vjeç / under 25 years	1.159	*	*	-
25 - 34	1.021	-	1.141	934
35 - 44	828	*	838	2.867
45 - 54	1.550	-	1.989	*
55 - 64	3.375	*	8.149	*
65 - 74	3.956	-	14.714	-
Mbi 74 vjeç / Over 74 years	4.584	-	14.925	*
Gjithsej / Total	16.473	*	*	*

**** Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti./ Hidden values for confidentiality reasons.***

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2018

Source: Household Budget Survey, 2018

(**) dhe (***) ju bëjmë me dije se të dhënat e ABF 2018 janë objekt revizionimi në vitin 2020 për shkak të ndryshimeve metodologjike

(**) and (***) HBS 2018 data are subject to revision in 2020 due to methodological changes

Njësitë ekonomike familjare sipas moshës dhe gjinisë së kryefamiljarit, 2018

Number of households by age and sex of head of household, 2018

Mosha e kryefamilajrit Age of Head of Household	Gjinia e kryefamiljarit Sex of head of houshold	
	Burra / Men	Gra / Women
Nën 25 vjeç / under 25 years	3.679	2.349
25 - 34	24.386	5.872
35 - 44	90.129	12.839
45 - 54	168.247	15.225
55 - 64	186.500	23.873
65 - 74	114.875	29.841
Mbi 74 vjeç / Over 74 years	65.274	29.573
Gjithsej / Total	**653.090**	**119.574**

**** Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti./ Hidden values for confidentiality reasons.***

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2018

Source: Household Budget Survey, 2018

(**) dhe (***) ju bëjmë me dije se të dhënat e ABF 2018 janë objekt revizionimi në vitin 2020 për shkak të ndryshimeve metodologjike

(**) and (***) HBS 2018 data are subject to revision in 2020 due to methodological changes

Shpenzimet mesatare mujore për konsum sipas gjinisë së kryefamiljarit, 2018

The monthly average consumption expenditures by sex of head of household , 2018

Grupet kryesore të konsumit	Gjinia / Sex		Gjithsej / Total	Main groups
	Burra / Men	Gra / Women		
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	34.034	30.172	33.436	Food and non-alcoholic beverages
Pije alkoolike dhe duhan	2.827	1.648	2.644	Alcoholic beverages, tobacco
Veshje dhe këpucë	3.384	2.602	3.263	Clothing and footwear
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	7.991	7.974	7.988	Housing, water, electricity, gas and other fuels
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	4.511	3.851	4.409	Furnishing, household equipment and routine maintenance of the dwelling
Shëndet	3.246	2.814	3.180	Health
Transport	5.627	2.566	5.153	Transport
Komunikim	2.830	2.351	2.756	Communication
Argëtim dhe kulturë	2.115	1.612	2.038	Recreation and culture
Arsim	2.337	2.099	2.300	Education
Restorante dhe hotele	3.743	2.603	3.567	Restaurants and hotels
Të tjera mallra dhe shërbime	5.435	3.926	5.202	Miscellaneous goods and services
Shpenzimet mesatare gjithsej	**78.080**	**64.218**	**75.935**	**Average total consumption expenditures**

**** Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti./ Hidden values for confidentiality reasons.***

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2018

Source: Household Budget Survey, 2018

(**) dhe (***) ju bëjmë me dije se të dhënat e ABF 2018 janë objekt revizionimi në vitin 2020 për shkak të ndryshimeve metodologjike

(**) and (***) HBS 2018 data are subject to revision in 2020 due to methodological changes

Struktura e shpenzimeve të konsumit sipas gjinisë së kryefamiljarit, 2018

The distribution of consumption expenditures by sex of head of household in percentage, 2018

(vlera në %)

Grupet kryesore të konsumit	Gjinia / Sex		Gjithsej / Total	Main groups
	Burra / Men	Gra / Women		
Ushqim dhe pije jo-alkoolike	43,6	47,0	44,0	Food and non-alcoholic beverages
Pije alkoolike dhe duhan	3,6	2,6	3,5	Alcoholic beverages, tobacco
Veshje dhe këpucë	4,3	4,1	4,3	Clothing and footwear
Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar	10,2	12,4	10,5	Housing, water, electricity, gas and other fuels
Mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje e zakonshme e banesës	5,8	6,0	5,8	Furnishing, household equipment and routine maintenance of the dwelling
Shëndet	4,2	4,4	4,2	Health
Transport	7,2	4,0	6,8	Transport
Komunikim	3,6	3,7	3,6	Communication
Argëtim dhe kulturë	2,7	2,5	2,7	Recreation and culture
Arsim	3,0	3,3	3,0	Education
Restorante dhe hotele	4,8	4,1	4,7	Restaurants and hotels
Të tjera mallra dhe shërbime	7,0	6,1	6,9	Miscellaneous goods and services
Shpenzimet mesatare gjithsej	**100,0**	**100,0**	**100,0**	**Average total consumption expenditures**

**** Vlera të fshehura për arsye konfidencialiteti./ Hidden values for confidentiality reasons.***

Burimi: Anketa e Buxhetit të Familjes, 2018

Source: Household Budget Survey, 2018

(**) dhe (***) ju bëjmë me dije se të dhënat e ABF 2018 janë objekt revizionimi në vitin 2020 për shkak të ndryshimeve metodologjike

(**) and (***) HBS 2018 data are subject to revision in 2020 due to methodological changes

Shpërndarja e shpeshtësisë së përdorimit të TIK sipas gjinisë, në %

ICT usage frequency distribution by sex, in %

Frekuenca e përdorimit	2018			2019			Usage frequency
	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	
Çdo ditë ose pothuajse çdo ditë	86,4	84,2	**85,4**	88,0	86,1	**87,1**	Every day or almost every day
Të paktën një herë në javë	12,2	14,2	**13,1**	10,5	12,6	**11,5**	At least once a week
Më pak se një herë në javë	1,4	1,6	**1,5**	1,5	1,4	**1,4**	Less than once a week

Burimi:Anketa mbi "Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët (TIK)"

Source: The Survey on "Information and Communication Technologies usage in Households and by Individuals (ICT)"

Shpërndarja e përdorimit të TIK sipas gjinisë, në %

ICT users distribution by gender, in %

Përdoruesit e TIK	2018			2019			ICT users
	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	Burra Men	Gra Women	Gjithsej Total	
Gjatë 3 muajve të fundit	66,3	59,0	**62,6**	71,2	66,0	**68,6**	Within the last 3 months
Midis 3 muajve dhe një viti më parë	2,2	2,5	**2,4**	1,3	0,9	**1,1**	Between 3 months and a year ago
Më shumë se 1 vit më parë	2,6	2,1	**2,3**	3,4	4,0	**3,7**	More than one year ago
Asnjëherë nuk e kam përdorur	28,9	36,5	**32,7**	24,1	29,1	**26,6**	Never used it

Burimi:Anketa mbi "Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët (TIK)"

Source: The Survey on "Information and Communication Technologies usage in Households and by Individuals (ICT)"

Blerjet online sipas grup-moshave dhe gjinisë, në %

Online purchases by age group and gender, in %

	2018				2019			
	Rroba, mallra sportive Clothing/sports equipment		Kompjuter/pajisje kompjuterike Computer/Comp equipment		Rroba, mallra sportive Clothing/sports equipment		Kompjuter/pajisje kompjuterike Computer/Comp equipment	
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women
16-24	46,4	53,6	85,8	14,2	37,4	62,6	65,0	35,0
25-34	31,8	68,2	63,1	36,9	46,4	53,6	61,9	38,1
35-44	47,7	52,3	79,6	20,4	46,5	53,5	49,5	50,5
45-54	36,4	63,6	51,3	48,7	42,8	57,2	100,0	-
55-64	52,1	47,9	74,6	25,4	58,0	42,0	90,9	9,1
65-74	32,8	67,2	100,0	-	17,6	82,4	100,0	-
Gjithsej	**40,9**	**59,1**	**74,8**	**25,2**	**43,1**	**56,9**	**63,3**	**36,7**

Burimi:Anketa mbi "Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët (TIK)"

Source: The Survey on "Information and Communication Technologies usage in Households and by Individuals (ICT)"

Të Drejtat e Njeriut

Human rights

Të Drejtat e Njeriut

Statistikat mbi të drejtat e njeriut pasqyrojnë të dhëna sipas gjinisë mbi ankesat për pretendime shkeljeje të të drejtave, të trajtuar nga Avokati i Popullit, sipas llojit të së drejtës. Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2019 ka shqyrtuar 1.384 ankesa të vlerësuara nga ekspertët e institucionit si ankesa "brenda juridiksionit dhe kompetencës" së Avokatit të Popullit. Burrat kanë paraqitur 919 ankesa (66,4 %) për pretendim shkeljeje të së drejtave, dhe gratë kanë paraqitur 338 ankesa (24,4 %). Ankesa për shkelje për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë, për vitin 2019 janë 127 (9,2 %). Në totalin e ankesave për pretendim shkeljeje të së drejtave, shumica e tyre i përkasin të drejtave në grupin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore.

Burrat kanë paraqitur më shumë ankesa për shkelje të së drejtave të personave të privuar nga liria (28,3 %), e drejta e pronës (17,4 %), dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor (10,7 %). Ndërsa gratë kanë paraqitur më shumë ankesa për shkelje të së drejtës për të përfituar nga sistemi i përkujdesit shoqëror (ndihma ekonomike) (25,4 %), e drejta për një proces të rregullt ligjor (14,8 %) dhe e drejta e fëmijës (11,2 %).

Gjatë vitit 2019 janë trajtuar 268 ankesa që lidhen me të drejtën e personave të privuar nga liria, prej të cilave 97,0 % janë paraqitur nga burrat e burgosur dhe 3,0 % janë paraqitur nga gratë e burgosura. Në totalin e ankesave të paraqitura, pretendimet për shkelje të së drejtës së personave të privuar zë peshën më të madhe të ankesave me 19,4 %. Numri më i madh i ankesave ka të bëjë me cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzimin e kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për t'u transferuar në një IEVP tjetër; transferimin e padrejtë në një IEVP tjetër; pretendimet për ushtrim dhune fizike, psikologjike dhe keqtrajtim; dhënia e padrejtë e masës disiplinore etj.

Në raport me popullatën në burgje rezultojnë më shumë ankesa të paraqitura nga gratë, në ndryshim nga ajo që tregon numri absolut. Kështu, nga totali i burrave të burgosur, 5,2 % e tyre kanë paraqitur ankesa, ndërkohë nga totali i grave të burgosura, 9,3 % e tyre kanë paraqitur ankesa.

Human rights

Human rights statistics reflect gender-based data on complaints of alleged violations of rights, handled by the People's Advocate, according to the type of right. The Institution of the People's Advocate protects the rights, freedoms and legitimate interests of the individual from illegal or irregular actions or omissions of public administration bodies, as well as third parties acting on its behalf.

During 2019, the People's Advocate Institution has reviewed 1,384 complaints after evaluation by experts of the institution as complaints "within the jurisdiction and competence" of the People's Advocate, Complaints filed by men for violations of rights are 919 complaints (66.4 %) and 338 complaints are filed by women (24.4 %). Complaints made in group, where both sexes benefit, for 2019 are 127 (9.2 %). In the total number of complaints for violation of rights, most of them belong to the group of economic, social and cultural rights.

Men have filed more complaints for violation of the rights of persons deprived of their liberty (28.3 %), the right to property (17.4 %), and the right to a fair trial (10.7 %). Women have filed more complaints for violation of the right to benefit from the social care system (economic assistance) (25.4 %), the right to a fair legal process (14.8 %) and the right of the child (11.2 %).

During 2019, 268 complaints related to the rights of persons deprived of their liberty were handled, of which 97.0 % were filed by imprisoned men and 3.0 % were filed by imprisoned women. In the total number of complaints filed, the allegations of violation of the right of deprived persons occupy the largest share of complaints with 19.4 %. The largest number of complaints concerns the quality of health care; refusing the request to obtain a rewarding permit; procrastination of the procedure to go with a rewarding permit; procrastination of the procedure to be transferred to another prison; unfair transfer to another prison; allegations of physical, psychological and ill-treatment; unfair disciplinary action, etc.

Compared to the prison population, there are more complaints from women, in contrast to the absolute number. Thus, out of the total number of imprisoned men, 5.2 % of them have filed complaints, while out of the total number of imprisoned women, 9.3 % of them have filed complaints.

Complaints about the right to property, during 2019 were treated 202 complaints in total, of which 79.2 % were filed by men, 13.4 % were filed by women and 7.4 % are

Lidhur me të drejtën e pronës, gjatë vitit 2019 janë trajtuar 202 ankesa gjithsej, prej të cilave 79,2 % janë paraqitur nga burrat, 13,4 % janë paraqitur nga gratë dhe 7,4 % janë ankesa të paraqitura në grup, ku përfitojnë të dyja gjinitë. Në totalin e ankesave të paraqitura, e drejta e pronës përbën grupin e dytë të të drejtave me më shumë ankesa të paraqitura (14,6 %) . Rezultojnë më shumë ankesa të paraqitura nga burrat pasi edhe shumica e titujve janë në pronësi të burrave.

Gjatë vitit 2019 janë trajtuar 154 ankesa lidhur me të drejtën për të përfituar nga sistemi i përkujdesit shoqëror (ndihma ekonomike), prej të cilave 37,7 % e ankesave janë paraqitur nga burrat, 55,8 % nga gratë dhe 6,5 % janë ankesa të paraqitura në grup, ku përfitojnë të dyja gjinitë. Në totalin e ankesave të paraqitura, e drejta për të përfituar nga sistemi i përkujdesit shoqëror përbën grupin e tretë të të drejtave me më shumë ankesa me 11,1 %. Në totalin e ankesave të paraqitura nga gratë, e drejta për të përfituar nga sistemi i përkujdesit shoqëror zë peshën kryesore të ankesave me 25,4 %.

Për herë të parë, që nga krijimi i Institucionit, drejtuesi/ Avokati i Popullit është grua. Struktura e Avokatit të Popullit përbëhet nga 5 Komisioner të zgjedhur nga Parlamenti dhe janë të gjitha gra. Prezenca më e madhe e grave shihet edhe te Ndihmës Komisionerët me 11 gra dhe 8 burra. Në zyrat rajonale janë 4 gra dhe 3 burra.

complaints filed in groups, where they benefit both sexes. In the total number of complaints filed, the right to property constitutes the second group of rights with the most complaints filed (14.6 %). There are more complaints from men, as most of the titles are owned by men.

During 2019, 154 complaints were processed regarding the right to benefit from the social care system (economic assistance), of which 37.7 % of complaints were filed by men, 55.8 % by women and 6.5 % are complaints submitted to the group, where both genders benefit. In the total number of complaints filed, the right to benefit from the social care system constitutes the third group of rights where there have been more complaints with 11.1 %. In the total number of complaints filed by women, the right to benefit from the social care system occupies the main share of complaints with 25.4 %.

For the first time since the establishment of the Institution, the leader / People's Advocate is a woman. The structures of the People's Advocate consist of 5 Commissioners elected by Parliament and are all women. The largest presence of women is also seen in the Assistant Commissioners with 11 women and 8 men. There are 4 women and 3 men in the regional offices.

Ankesa për shkelje të së drejtave sipas gjinisë, 2019

Complaints filed for violation of the right by sex, 2019



Burimi: Avokati i Popullit
Source: The People's Advocate
Shënim: Të tjera përfaqësojnë pretendime për shkelje për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë
Note: Others represent complaints for violation for various interest groups where both sexes benefit

Rekomandime të trajtuara sipas gjinisë, 2019

Recommendations addressed by gender, 2019



Burimi: Avokati i Popullit
Source: The People's Advocate
Shënim: Të tjera përfaqësojnë rekomandime për shkelje për grupe të ndryshme interesi ku përfitojnë të dyja gjinitë
Note: Others represent recommendations for violation for various interest groups where both sexes benefit

Ankesa sipas të drejtës së shkelur dhe gjinisë, 2019

Complaints filed for violation of the right by sex, 2019

Të drejta	Burra Men	Gra Women	Ankesa gjithsej	The rights
E drejta e jetës	13	5	19	The right to life
E drejta e informimit	25	9	35	The right to information
Liria e ndërgjegjes dhe e fesë	1	0	1	Freedom of conscience and religion
E drejta për një proces të rregullt ligjor	98	50	151	The right to a fair trial
E drejta e pronës	160	27	202	Property right
E drejta për tu mbrojtur nga diskriminimi	6	1	7	The right to be protected from discrimination
Të drejtat e personave të privuar nga liria	260	8	268	The rights of persons deprived of their liberty
E drejta për tu mbrojtur nga ushtrimi i torturës	28	2	30	The right to be protected from the exercise of torture
E drejta për tu zgjedhur dhe për të zgjedhur	0	0	2	The right to be elected and to be elected
Liria e tubimeve	4	1	10	Freedom of assembly
E drejta për punë	32	17	49	The right to work
E drejta për kujdes shëndetësor	38	23	62	The right to health care
E drejta për edukim	29	17	46	The right to education
E drejta për strehim	31	28	59	The right to housing
E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore	67	21	90	The right to benefit from the social security system
E drejta për të përfituar nga sistemi i përkujdesit shoqëror (ndihma ekonomike)	58	86	154	The right to benefit from the social care system (economic assistance)
Të drejtat e fëmijës	51	38	152	The rights of the child
E drejta për një mjedis të shëndetshëm	17	5	37	The right to a healthy environment
Të drejtat e minoriteteve	1		10	Minority rights
Gjithsej	919	338	1384	**Total**

Burimi: Avokati i Popullit

Source: The People's Advocate

Shënim: Në totalit e ankesave për shkelje janë përfshirë edhe ankesat ku përfitojnë të dyja gjinitë

Note: The total number of complaints for violations also includes complaints where both sexes benefit

Ankesa për shkelje të së drejtave depozituar nga burrat në %, 2019

Complaints of violation of men's rights in %, 2019



Burimi: Avokati i Popullit

Source: The People's Advocate

Ankesa për shkelje të së drejtave depozituar nga gratë në %, 2019

Complaints of violation of women's rights in %, 2019



Burimi: Avokati i Popullit

Source: The People's Advocate

Përqindja e burrave të burgosur që kanë depozituar ankesa për shkelje të së drejtave, 2019

Percentage of imprisoned men who have filed complaints for human rights violations, 2019



Burimi: Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Source: The People's Advocate, General Directorate of Prison

Përqindja e grave të burgosura që kanë depozituar ankesa për shkelje të së drejtave, 2019

Percentage of imprisoned women who have filed complaints for human rights violations, 2019



Burimi: Avokati i Popullit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Source: The People's Advocate, General Directorate of Prison

Personeli i Institucionit të Avokatit të Popullit, 2019

The personel of the People's Advocate, 2019

Personeli	Nr		%		Personel
	Burra Men	Gra Women	Burra Men	Gra Women	
Drejtues i lartë/Avokati i Popullit	0	1	0,0 %	100,0 %	Senior Leader / People's Advocate
Kabineti	3	4	42,9 %	57,1 %	The Cabinet
Sekretar i Përgjithshëm	1	0	100,0 %	0,0 %	General Secretary
Komisioner	0	5	0,0 %	100,0 %	Commissioner
Drejtor drejtorie	0	1	0,0 %	100,0 %	Director of the directorate
Ndihmës Komisioner	8	11	42,1 %	57,9 %	Assistant Commissioner
Shërbime dhe të tjerë	5	14	26,3 %	73,7 %	Services and others
Zyrat rajonale	3	4	42,9 %	57,1 %	Regional offices

Burimi: Avokati i Popullit

Source: The People's Advocate

Indeksi i Pabarazisë Gjinore

Gender Inequality Index



Indeksi i Pabarazisë Gjinore

Indeksi i Pabarazisë Gjinore (IPGJ), është një tregues i përbërë, i modeluar në mënyrë të tillë që të paraqesë nga ana sasiore humbjen në zhvillimin njerëzor të mundshëm në një vend, si rezultat i pabarazive gjinore. Ky indeks jep një bazë empirike për analizat e politikave gjinore dhe për fushat se ku duhen të fokusohen përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore. I.P.GJ paraqet disavantazhet gjinore në tre dimensione – shëndetin riprodhues, fuqizimin dhe tregun e punës. Ky indeks tregon humbjen potenciale në zhvillimin njerëzor, si rezultat i pabarazive ndërmjet arritjeve të grave dhe burrave në këto dimensione. I.P.GJ mund të marrë vlera nga 0, ku arritjet e grave dhe burrave janë të barabarta, në 1, ku njëra nga gjinitë ka rezultatet më të këqija të mundshme në të gjitha dimensionet. [Human Development Report, Kombet e Bashkuara, 2015].

Më poshtë listohen të gjithë treguesit e nevojshëm për llogaritjen e Indeksit të Pabarazisë Gjinore sipas dimensionit të cilit i përkasin dhe burimin të të dhënave.

Shëndeti riprodhues

Vdekshmëria amtare për 100.000 lindje
[7,00 në vitin 2019]
(INSTAT, Ministria e Shëndetësisë)
Norma e lindshmërisë së adoleshenteve
[14,20 për mijë, në vitin 2019]
(INSTAT).

Prioriteti që i jepet shëndetit të grave gjatë periudhës së shtatzanisë dhe lindjes është një shenjë e qartë e statusit të tyre në shoqëri. Rreziku i vdekjes së grave në lindje mund të reduktohet nëpërmjet edukimit të tyre dhe përmirësimit të kujdesit shëndetësor që u ofrohet. Gjithashtu, lindja në moshë të re përveç se paraqet një rrezik të lartë për shëndetin e nënës dhe të fëmijës, e bën më të vështirë për gratë që të arrijnë nivele më të larta arsimimi, të cilat janë të nevojshme për suksesin e tyre në tregun e punës.

Fuqizimi

Përqindja e vendeve në parlament sipas gjinisë
[29,51 % gratë; 70,49 % burrat, në vitin 2019]
(Kuvendi i Shqipërisë).
Kryerja e arsimit të mesëm ose më të lartë, sipas gjinisë për moshat mbi 25 vjeç
[88,8 % gratë; 92,7 % burrat, në vitin 2019]
(Anketa e Forcave të Punës, INSTAT).

Gender Inequality Index

The Gender Inequality Index (GII) is an index for measurement of gender disparity in terms of human development of a country, as a result of gender inequalities. In addition, this index serves as an empirical base for the analyses of gender policies, and areas where efforts for reaching gender equality should focus. GII presents gender disadvantages from three perspectives: reproductive health, empowerment and the labor market. This index marks potential loss in human development, as a result of inequalities between achievements of females versus males in these aspects. GII may have a value of 0, when achievements of females and males are equal, to 1 where one of the genders has the worst possible results in all dimensions. [Human Development Report, United Nations, 2015].

Below is a list of the indicators necessary for the calculation of the Gender Inequality Index, according to the dimension they belong to, and the respective source of data.

Reproductive health

Maternal mortality rates for 100.000 births
[7.00 in 2019]
(INSTAT, Ministry of Health)
Adolescent fertility rate [14.20 per thousand, in 2019]
(INSTAT)

The priority that is given to women's health during their pregnancy and birth is a clear indicator of their status in the society. In many countries worldwide, including Albania, the risk of maternal death may be reduced through education, and by improving health care. In addition, giving birth at a tender age, besides presenting high risk for the maternal health and the health of the child makes it more difficult for women to have better education results, which are necessary for their further prospective success in the labor market.

Empowerment

Proportion of seats held in Parliament according by sex [29.51 % women; 70.49 % men, in 2019]
(Albanian Parliament)
Completion of secondary or higher education for ages above 25 years
[88.8 % women; 92.7 % men, in 2019]
(Labor Force Survey, INSTAT)

Gratë kanë qenë tradicionalisht të disavantazhuara në fushën politike, në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të përfaqësimit. Përqindja e grave në parlament është një vlerësim për shkallën në të cilën gratë mund të mbajnë poste të larta drejtuese në një shoqëri. Nga ana tjetër, gratë me nivele më të larta arsimimi kanë më shumë mundësi të jenë më të suksesshme në tregun e punës, janë më të afta të kujdesen për shëndetin e tyre dhe atë të familjes, si dhe e kanë më të lehtë të ndërmarrin iniciativa, përfshirë dhe ato politike.

Tregu i punës

Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës
[53,0 % gratë; 68,0 % burrat, në vitin 2019]
(Anketa e Forcave të Punës, INSTAT).

Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës paraqet gatishmërinë e personave për të marrë pjesë në tregun e punës si dhe perceptimin që ata kanë rreth mundësive të punësimit. Një aspekt i rëndësishëm për gratë dhe pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës është mundësia e kombinimit të punës produktive me jetën riprodhuese. Mungesa e kësaj mundësie mund të detyrojë një pjesë të mirë të grave të tërhiqen tërësisht nga forcat e punës.

Indeksi i pabarazisë gjinore

Sipas llogaritjeve, për vitin 2019, Indeksi i Pabarazisë Gjinore është rritur në 0,10 nga 0,07 që shënonte një vit më parë. Kjo tregon një humbje në zhvillimin njerëzor si rezultat i pabarazisë gjinore prej 10,0 %.

